

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
“SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME” DIBËR sh.a
DREJTORIA E SHERBIMEVE MBESHTETESE
SEKTORI JURIDIK

Nr. _____ Prot.

Date, më ___/___/2026

Shtojca 13.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË
ANKIMIT**

[Data]05.05.2026

Drejtuar: Shoqëria “ARENA MK” sh.p.k

Operatorit Ekonomik (OE) ose

[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

“ARENA MK” sh.p.k Nipti: L67619801Q, Përqindja 55 % , Adresa: Fier Ballsh Fshati Ninësh;
Rruga Dames -Ninesh; Ndertesa 4; Lagja Memaj; Nj.Adm.Fratar; Bashkia Mallakaster 9328
& “INSTITUTI DEKLIADA - ALB” sh.p.k Nipti: K71606006A Përqindja 45%, Adresa:
TIRANE Rruga Donika Kastrioti, pallati Teknoprojekt, apartamenti 9/1, 1001

- OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: **Kontrate publike Sherbime**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **E Hapur Mbi kufirin e larte monetare.**

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-74860-02-01-2026** Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasisë dhe kohëzgjatja e kontratës]* **“Studim Projektim për Rrjetin ujësjellës dhe Kanalizime , Korabi” Kohezgjatja e kontrates 3 (tre) muaj**

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 07.4.2026

¹Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit *[Data] [Numri] datë 14 Prill 2026 Buletini Nr. 26*

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto X
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1. (BOE) “HYDRO-ENG CONSULTING” sh.p.k <u>48%</u>	M11417503F
& “P.C.S.COMPANY” sh.p.k <u>17%</u>	K91527021J
& “INVICTUS” sh.p.k <u>13%</u>	L12213005M
& ”IDEAL CONSTRUKTION AND PROJEKTION (I.C.P)”sh.p.k 13%	L91310511L
& “SIRE-LAB” sh.p.k <u>9%</u>	M36415202E

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 46,339,529.04 (dyzet e gjashtë milion e treqind e tridhjetë e nente mijë e pesëqind e njetzet e nente pike, zero kater) lek pa tvsh.

Piket e marra ne total 273 pike (dyqinde e shtatedhjetë e tre pike)

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. (BOE) “ARENA MK” sh.p.k <u>55%</u>	L67619801Q
& “INSTITUTI DEKLIADA - ALB” sh.p.k <u>45%</u>	K71606006A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

Vlera **46,400,000** (dyzet e gjashte milion e katerqind mije) lek pa TVSH, Piket e marra ne total 282 pikë (Dyqinde e tetedhete e dy)

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. (BOE) “Gjeokonsult &CO” sh.p.k	83.3 %	K91810005U
& “A.SH. Engineering” sh.p.k	8.7 %	L31617003F
& “INFRATECH” sh.p.k	4 %	K91628001D
& “INSTANT.AL” sh.p.k	4 %	L81506043D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: **47,477,700** (dyzete e shtate milion e katerqind e shtatedhete e shtate mije e shtateqind)lek pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Etj. _____

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

(BOE) “Gjeokonsult &CO” sh.p.k	83.3 %	K91810005U
& “A.SH. Engineering” sh.p.k	8.7 %	L31617003F
& “INFRATECH” sh.p.k	4 %	K91628001D
& “INSTANT.AL” sh.p.k	4 %	L81506043D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet e mëposhtme:

Komisioni i vlerësimit të ofertave bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik në poltësim të kërkesave të autoritetit kontraktor për procedurën e prokurimit objekt vlerësimi, konkludon se:

Bazuar në kërkesën e pikës 2.3.1 të kapacitetit teknik si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 35% e vlerës së përlogaritur të objektit që prokurohet.

3. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
4. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Operatorët në plotësim të kësaj pikë kanë paraqitur si më poshtë:

Operatori ekonomik INSTANT.AL (pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomik)

- Faturë tatimore Nr.53/2023 “Blerje IPAD, smartboards, laptop” ne vlerë 699,990 lek pa tvsh
- Faturë tatimore Nr.31/2023 “krijim dhe dizënjim i aplikacioni Visit Durrës” ne vlerë 320,500 lek pa tvsh
- Faturë tatimore Nr.66 /2023 “Mirëmbajtje faqes zyrtare të internetit të Fakultetit të Drejtësisë, upgrade dhe update 140 000 lek pa tvsh
- Faturë tatimore Nr.15 /2022 “Zhvillim faqe web” ne vlerë 50 000 lek pa tvsh
- Faturë tatimore 18/2022 “Mirembajtje per faqet e webit spak.al dhe bkh.a” ne vlerë 25 000 lek pa tvsh
- Faturë tatimore 34/2022 “Mirembajtje per faqet e webit spak.al dhe bkh.al” ne vlerë 25 000 lek pa tvsh
- Faturë tatimore 7/2023 “Mirembajtje per faqet e webit spak.al dhe bkh.al” ne vlerë 50 000 lek pa tvsh
- Faturë tatimore 26/2023 “Mirembajtje per faqet e webit spak.al dhe bkh.al” ne vlerë 37 500 lek pa tvsh
- Faturë tatimore 65/2023 “Mirembajtje e Sistemeve Informatike” ne vlerë 565 000 lek pa tvsh
- Faturë tatimore 14/2024 “Krijimi i faqes ëeb dhe aplikacionit mobile “Korça Innovation Hub Groë Global” ne vlerë 250 600 lek pa tvsh
- Faturë tatimore 94/2024 “Mirembajtje e Sistemeve Informatike” ne vlerë 565 000 lek pa tvsh
- Faturë tatimore 112/2024 “Krijimi/ridizënjim/projektim i faqes ëeb/ Trajnimi i punonjësve përgjegjës për ëeb/ Mirëmbajtja e faqes ëeb” ne vlerë 500 000lek pa tvsh
- Faturë tatimore 32/2025 “Aplikacion për ndërveprim me publikun dhe grupet e interesit” ne vlerë 4 674 800 lek pa tvsh
- Faturë tatimore 54/2025 “Ndertimi/Zhvillimi Platforme Menaxhimi per Materiale Arkivore” ne vlerë 4 424 000 lek pa tvsh
- Faturë tatimore 59/2025 “Ndertimi/Zhvillim Platforme Softëare per ERP ATOM” ne vlerë 13 200 000 lek pa tvsh
- Kontrate me vlere 840,700 lek pa tvsh Blerje kompjutera dhe printera per Bashkine Kruje
- Kontrate me vlerë 4 973 000 lek pa tvsh Blerje shërbimi per instalim dhe konfigurim firewall, router, switch”
- Kontrate me vlerë 8 994 800 lek pa tvsh, Blerje sistemit te menaxhimit te konsultimit publik dhe shërbim mirembajtje
- Kontrate 1800 000 lek pa tvsh, shërbim mirembajtje Full Risk per infrastrukturën e rrjetit te sigurise
- Kontrate 2 340 000 lek pa tvsh, blerje paisje elektronike per qendren multifunksionale per te rinjte Fier
- Kontrate 895 035 lek pa tvsh Blerje paisje informatike
- Kontrate 175 000 lek pa tvsh , Blerje shërbim mirembajtje IT
- Kontrate 1 330 000 lek pa tvsh Blerje paisje elektornike per EKB

Komisioni gjykon se përmbushja e kriterëve ekonomike, teknike, profesionale në rastin konkret është një detyrim që buron nga ligji i cili në mënyrë taksative kërkon përmbushjen e tyre nga të gjithë anëtarët e bashkimit.

Qëllimi i shprehur qartësisht në nenin 88 pika 3 e VKM nr.285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, është që secili nga operatorët e bashkimit të disponojë kapacitetet teknike profesionale në përputhje me përqindjen që kanë marrë përsipër të realizohet nga secili prej tyre.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë **jo më të vogël se 35% e vlerës** së përlllogaritur të objektit që prokurohet.

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pas kontrollit dhe verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në plotësim të kësaj pikë të kriterëve të vecanta të kualifikimit verën se operatori ekonomik “**INSTANT.AL**” **shpk** nuk plotëson punën e ngjashme për shkak të natyrës së punëve të cilat ka paraqitur.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga operatori ekonomik “**INSTANT**” **sh.p.k.**, në përmbushje të kriterit për punime të ngjashme, Komisioni konstaton se operatorin, dëshmon se ka kryer punime të ngjashme vetëm në furnizim mallrash si psh, kompjutera, printera, shërbime IT, mirmbajtje faqesh, por në asnjë rast nuk dëshmon se disponon eksperiencën e nevojshme për studim projektive sipas objektit të prokurimit, theksojmë faktin se studim projektimet kërkojnë ekspertizë dhe eksperincë të ndryshme nga ato të dëshmuara nga operatorin me anë të kontratës së paraqitur, pasi edhe metodologjia e shërbimit të tyre është e ndryshme .

Komisioni gjykon se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës nëse ajo është një kontratë në vlerë, por duhet parë në lidhje me të gjithë natyrën e prokurimit që zhvillon autoriteti kontraktor.

Gjithashtu, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me shërbimin objekt prokurimi.

Konkretisht, kontratat e paraqitura nga INSTANT.AL sh.p.k, nuk mund të konsiderohen as si kontrata të ngjashme pasi nuk përmbushin karakteristikat e kontratës në natyrë, kompleksitet dhe metodologji. Natyra e objekteve të paraqitura nga OE nuk është e ngjashme pasi produkti është i ndryshëm. Produkti që kërkohet në objektin e prokurimit është studim projektive në fushën e ujesjelles kanalizimeve etj. Ndërkohë që kontratat e ngjashme të paraqitura prej OE janë gjerësisht furnizim mallrash dhe shërbime it, etj,”

Komisioni konstaton, se nuk përputhet elementi natyrë e ngjashme, pasi nuk bazohet në natyrën, kompleksitetin ose karakteristika të tjera të përshkruara në detyrën e projektimit. Furnizimet e mallrave dhe shërbimeve IT, janë dy kategori të ndryshme. Pra, si përfundim, këto kontrata nuk mund të konsiderohen aspak kontrata me natyrë të ngjashme, me objektin e prokurimit.

KVO gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi.

Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për eksperiencën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi.

Sa më sipër, **KVO konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, bashkimi i operatorëve ekonomik nuk e plotëson kriterin 2.3.1 a) dhe b) të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit.**

Referuar rasteve të ngjashme të KPP me Vendimin Nr. 611/2020

Në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik INSTANT.AL (pjesë e bashkimit të operatoreve ekonomik), rezulton se ky operator nuk ka paraqitur licensën e kërkuar nga AK në plotësim të pikës 2.3.2 të kriterëve të vecanata të kualifikimit.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë projektimi sipas rregullores së miratuar me *VKM nr. 943, datë 28/12/2016* “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

KREU III LICENCAT PROFESIONALE - KATEGORITË, ELEMENTËT DHE KUFIZIME Neni 16
Licenca - kategoritë e punimeve

1. Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të ushtrorë veprimtari të caktuar profesionale, sipas kategorive të punimeve të fituara në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim.

2. Kategorive e punimeve në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim, përfitohen mbështetur në profilin e diplomës dhe njëkohësisht duke vlerësuar eksperiencën profesionale sipas kushteve dhe kritereve të specifikuara në këtë rregullore.

3. Kategoritë e punimeve të studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit, sipas të cilave kërkohen dhe jepen licencat profesionale, paraqiten respektivisht në lidhjet e rregullores.

Neni 24

Kushtet paraprake për licencë profesionale shoqërie

Kushtet paraprake për licencë profesionale për shoqëri/studio, janë:

1. Për studimin e projektimin:

a) Të jenë regjistruar si person juridik, sipas dispozitave ligjore, për të ushtruar veprimtari në studim e projektim;

b) Të ketë drejtues teknik një ose më shumë individë, të pajisur me licencë profesionale individuale për studim e projektim;

Duke marr parasysh natyrën e objektit të prokurimit e cila është studim projektim në fushën e ndertimit operatorët duhe të paraqesin licencën në projektim sipas rregullores së miratura me VKM nr.943.

Duke qene se ky operatorë ka marre persiper 8.7% te realizmit te sherbimeve per kete procedure duhet te jete operatorë i licensuar ne studim projektme, pamvarsisht se ne formularin permbledhes te vetdeklarimit ky subject ka marre persiper dhe deklaruar vetem nje staf it, subjekti duhet te disponoje licensen perkatese ne projektim.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbeje autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Referuar rasteve të ngjashme të Komisionit të Prokurimit Publik me Vendimin Nr. 1047/2022

Në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik (pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomik) si dhe nga verifikimet e kryera nga kvo, ky operator nuk përmbush piken

a) të kritereve të përgjithshme të kualifikimit, si me poshte:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas

legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

Nga verifikimi rezulton se ky operator ekonomik nuk ka ne objektin e tij te veprimtarise studim projektimet.

Theksjome faktin se plotesimi i ketij kriteri eshte kryesori dhe kriteri baze per cdo shoqeri e cila konkuron per nje kontrate publike.

Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht se: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet.

Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.",

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësite organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës." 1.2.4. Në nenin 26 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" të Vendimit Nr. 285 date 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë Vijn:

- a)** operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b)** operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c)** personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfundimtare, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është ne proces falimentimi;

e) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shogërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

f) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 te Ligjit Nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik", te ndryshuar me Ligjin Nr. 16 datë 08.02.2024 ku parashikohet:

Autoriteti ose enti kontraktor, ne zbatim te pikës 4 të këtij neni, vlerëson nje oferte te vlefshme vetëm nese ajo është në përputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara në njoftimin e kontrates dhe në dokumentet e tenderit, pa renë ndesh me percaktimet e nenit 38 te këtij ligji",

Komisioni i Vleresimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor per arseyt e siper cituara bëri skualifikimin e OE (BOE) “Gjeokonsult & CO” sh.p.k me Nr.NIPT K91810005U & “A.SH. Engineering” sh.p.k me NIPT L31617003F & “INFRATECH” sh.p.k me NIPT K91628001D & “INSTANT.AL” sh.p.k NIPT L81506043D

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] **OE (BOE) “ARENA MK” sh.p.k Nipti: L67619801Q, Perqindja 55 % , Adresa: Fier Ballsh Fshati Ninësh; Rruga Dames -Ninesh; Ndertesa 4; Lagja Memaj; Nj.Adm.Fratar; Bashkia Mallakaster 9328 & “INSTITUTI DEKLIADA - ALB” sh.p.k Nipti: K71606006A Perqindja 45%, Adresa: TIRANE Rruga Donika Kastrioti, pallati Teknoprojekt, apartamenti 9/1, 1001 se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/ **46,400,000 (dyzet e gjashte milion e katerqind mije) lek pa TVSH,** është identifikuar pikët totale të marra [**282**] (**Dyqinde e tetedhjetë e dy**) **pikë** është identifikuar si oferta fituese.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor dhe referenca e kontaktit]Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime-Diber Sha me Adrese: Lagjia e “Re”, mbrapa Nënprefekturës, kati i 2, godina 7-katë, Bulqizë , sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata

do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], : **46,339,529.04 (dyzet e gjashte milion e treqind e tridhjetë e nente mijë e pesëqind e njetzet e nente pike, zero kater) lek pa tvsh.**

Piket e marra ne total 273 pike (dyqinde e shtatedhjetë e tre pike)

siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO X JO

Nëse Po (Nr. __ Datë __ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik) Vendim Nr. 579/2026 / Nr. 1166/6 prot. Date 04.05.2026

[Titullari i autoritetit /Entit kontraktor]

**Erger KOSIQI
ADMINISTRATOR**